



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.09.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për të drejtën e informimit”.
3. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Eduard Halimi, Tom Doshi dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Edlira Jorgaqi – drejtore e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Eduard Pesendorfer – këshilltar ligjor i OSBE-së

Blerina Fani – asistente ligjore në OSBE

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Meqenëse kuorumi është i realizuar, mbledhja mund të çelet normalisht, e cila në rend të ditës ka dy projektligje që janë shqyrtuar, miratuar në parim dhe sot do t'i shqyrtojmë nen për nen.

Projektligji i parë është “Për të drejtën e informimit”.

E pranishme është zonja Jorgaqi, drejtore e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Ju dhe zonja Hysi do të jeni duke ndjekur projektin. Fillojmë me nenin 1 të projektit. Ka vërejtje, sugjerime, propozime? Nuk ka.

Kush është dakord për nenin 1? Faleminderit! Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 2, pika 1 dhe germa “a” ka një përsëritje, sepse në fakt kur themi autoriteti publik është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative. Në këtë përkufizim Kodi i procedurave administrative përfshin dhe organet e qeverisjes vendore dhe entet publike, të cilat kryejnë funksione administrative. Ne mund ta lëmë në këtë formë, por ka përsëritje. Pra, enti publik dhe organet e njësisë vendore janë të përfshira tek pjesa e parë e fjalisë, ku thuhet “çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative”. Kjo është çështja e parë.

E dyta, në pikën 2 të po këtij neni, kur thuhet informacion publik, është çdo dokument i mbajtur nga autoritetet publike. Pavarësisht nëse është përpiluar ose jo prej tyre sugjeroj ta riformulojmë duke pasur parasysh edhe konventën evropiane për të drejtën mbi informacionet zyrtare. Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Pra, presupozohet që nuk është thjesht vetëm dokumenti zyrtar, por mund të jetë një CD, mund të jetë një komunikim elektronik. Dhe flitet vetëm për ato informacione që organi publik, autoriteti publik i ka siguruar për shkak të funksionit dhe jo që t'i ketë siguruar në rrugë private dhe që i mban në institucion.

Gjithashtu, pikën 3 mendoj se duhet ta përshtatim edhe me Kushtetutën dhe konkretisht në Kushtetutë në nenin 16 të Kushtetutës sanksionohet që e drejta për informim, 16 dhe 23, gëzohet edhe nga personat, shtetasit pa shtetësi. Ndërkohë që ne duhet ta parashikojmë një gjë të tillë nëse bëhet fjalë për personin që ka të drejtë të marrë informacion. Pra të themi person dhe çdo person fizik ose juridik vendas, i huaj ose person pa shtetësi.

Fatmir Xhafaj - Këto janë sugjerimet. Po, zonja Jorgaqi. Dakord.

Ka vërejtje të tjera? Po, zoti Subashi.

Armando Subashi - Faleminderit!

Në fakt tek pika 1, te përkufizimi që jepet për autoritetin publik te pika “b” paragrafi i tretë, pra shoqëritë tregtare që marrin fonde nga buxheti i shtetit, unë sugjeroj që kjo duhet të hiqet. Pra, kush e ka të drejtën për të informuar publikun? Të drejtën për të informuar publikun, rregulli bazë, parimi bazë, e kanë institucionet shtetërore, e kanë autoritetet publike ose të gjitha ato subjekte të cilat me ligj apo me akte të tjera marrin për një kohë të caktuar funksione publike. Pra, ushtrojnë funksione publike. Nga kjo pikëpamje ne nuk duhet ta hapim kaq shumë, po themi, këtë lloj të drejte sa të shkojmë deri te subjektet private dhe të kërkojë informacion te një subjekt privat, sepse e drejta bazë që njihet dhe nga Kushtetuta, që është e drejta e informimit, nuk është një e drejtë e pakufizuar. Ka dhe ajo një kufi. Dhe është e pakufizuar në raport me institucionet shtetërore, me institucionet publike, por jo me të gjithë aktorët dhe faktorët, që operojnë në një shoqëri, qofshin edhe subjekte tregtare.

Kështu që unë mendoj se kjo duhet të hiqet dhe subjektet tregtare duhet t'i çlirojmë nga kjo pjesë. Nëse dikush kërkon një informacion si janë përdorur iks fonde publike, si është bërë një tender, se kush e ka fituar etj., i drejtohet zyrës së shtetit, institucionit përkatës, se kësaj i bie që ta kapim veshin së prapthi.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Ka vërejtje të tjera? Dakord.

Ka kundërshtime për sugjerimet që u bënë për nenin 2?

Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi - Po t'i referohemi Kushtetutës, nenit 23, kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të

personave, që ushtrojnë funksione shtetërore. Po t'i referohemi Konventës së Këshillit të Europës për të drejtën e informimit, për dokumentet zyrtare, u rekomandohet shteteve të përcaktojnë vetë, nëse do t'i përfshijnë shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve. Pra, i vihet ligjvënësit ose fonde nga buxheti i shtetit. Pra, vetëm për atë pjesë të veprimtarisë që financohet nga buxheti i shtetit.

Ajo që më shqetëson, zoti kryetar, është edhe mënyra si është përkufizuar ose formuluar shkronja “c”, ku thuhet: “edhe në fusha të tjera si këto”. Pra, kur thuhet që çdo person fizik ose juridik, që ushtron funksione publike në fusha të tilla si, që në ligj zakonisht ne nuk i përdorim këto terminologji arsimit, shëndetësia, energjia, telekomunikacioni e fusha të tjera si këto, për aq sa veprimtaria e tyre lidhet me funksionet publike.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka dashur ta bëjë shteruese. Nuk ka ndonjë gjë të keqe.

Ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar?

Armando Subashi – Te shkronja “c” ndoshta mund të marrim formulimin që e kemi bërë te ligji “Për gjykatat administrative”. Pra, atje kemi dhënë përkufizimin se cilat janë organet e administratës shtetërore dhe një nga rastet është edhe kur personit fizik ose juridik, me ligj apo me akte të tjera nënligjore, i jepet e drejta për të ushtuar funksione publike dhe nuk kemi pse ta specifikojmë arsim, shëndetësi. Nëse themi këtë fusha është e hapur për të gjitha gjërat. Pra, është zgjeruese dhe jo shteruese. Pra, nëse ka marrë të drejtën për të ushtruar funksionet publike ka të drejtën të informojë.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me sugjerimet për nenin 2?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me formulimin e nenit 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Në nenin 4, te pika 2, shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si më poshtë vijon: “Në përgatitjen e programit të transparencës autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë publik dhe sidomos përmenden shkronjat “a” dhe “b”, që janë në variantin e qeverisë dhe shtohet shkronja “c”, modelet e miratuara për

kategorinë e autoritetit publik nga komisioneri për të drejtën e informimit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale sipas nenit 6 të këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Ka sugjerime të tjera?

Zonja Jorgaqi jeni dakord?

Edlira Jorgaqi – Në parim jemi dakord, por thjesht për të qenë korrekt në teknikën legislative, në relacion nuk të thuhet do të shoqërojë projektligjin që nuk shtohet paragraf në rast se do të çmohet për t’u shtuar realisht shkronja “c”, por është nënparagraf. Nënparagraf, jo pikë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Neni 5 bën fjalë për rishikimin e programit të transparencës. Sugjerohet të shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë vijon: “Në rastet kur komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale konstaton se autoriteti publik nuk rishikon programin e transparencës, sipas modelit të miratuar prej tij, ai jep udhëzimet e nevojshme dhe një afat për përmbushjen e këtij detyrimi.”

Fatmir Xhafaj – Zonja Jorgaqi, urdhëroni!

Edlira Jorgaqi - Unë do t’ju kujtoja nenin 18 të projektligjit, konkretisht shkronjat “c” dhe “ç”, se çfarë propozohet. Në nenin 18 është e parashikuar si shkelje. Është sanksion, dhe përderisa është sanksion i ul nivelin e mbrojtjes së kësaj marrëdhënieje nëpërmjet udhëzimit që i jep të drejtën komisionerit për të nxjerrë. Ne themi te neni 18 që është sanksion, këtu tani themi që nxjerr udhëzim. Do ta mbrojmë, apo jo?

Fatmir Xhafaj – Mendoj se ministria ka të drejtë. Le ta shikojmë kur të shkojmë te neni 18. Dakord?

Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6, programet model të transparencës. Relatorja nuk ka gjë për të shtuar.

Ai që ka mundësi ta bëjë me postë elektronike, le ta bëjë.

Neni 7. Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Është një shtesë e vogël. Në germën “d” të nenit 7 bëhet fjalë për kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë. Krahës të dhënave për arsimim, kualifikim dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrim për deklarimin e pasurisë, të shtohet edhe procedura e zgjedhjes së tyre. Domethënë, çdo njeri ta ketë të qartë si zgjidhen këto pozicione, me konkurs apo ...

Fatmir Xhafaj – Ato janë publike.

Vasilika Hysi – Po pra, kjo është, të bëhet edhe në faqen e internetit.

Fatmir Xhafaj – Po nuk bëhet, nuk të lë ligji. Nuk të lënë ligjet që e rregullojnë. Në qoftë se do t’i shtojmë siç shtoi miell, shtoi ujë...

Vasilika Hysi – Jo, jo, kjo është te faqja e internetit e institucionit. Ajo që është publike, të shtohet te faqja e internetit të institucionit, se këtu bëhet fjalë për kategoritë e informacioneve që bëhen publike pa kërkesë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull. As shton, as pakëson ndonjë gjë. Dakord, negative nuk është.

Ka ndonjëri vërejtje? Nuk ka.

Dakord me vërejtjen, me sugjerimin?

Në rregull.

Neni 8 “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”.

Vasilika Hysi – Neni 8 bën fjalë për detyrimin që ka autoriteti publik për të krijuar, për të mbartur dhe për të bërë publik një regjistër të posaçëm, si dhe për ta përditësuar atë çdo tre muaj. Ky projekt parashikon tri mënyra të bërjes publike të këtij regjistri.

E para, botimi në faqen e internetit të autoritetit.

E dyta, në mjedisin e pritjes së publikut dhe, e treta, në mjedisin e autoritetit publik.

Në fakt, nuk e di sa realisht do të ishte e mundur që ky regjistër së bashku me kërkesën për informim dhe me përgjigjet e dhëna të afishoheshin në mjedisin e pritjes së publikut.

Unë kam sugjeruar një riformulim në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Drejtësisë, ndërkohë edhe me një nga ekspertët e SOROS-it: “Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për

informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo tre muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarit të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.”

Njëkohësisht, pika 2 mund të riformulohet: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale mund të vendosë standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit”, sepse ka një problem këtu, zoti kryetar. Ne heqim identitetin e kërkuarit, por informacioni mund të përmbajë të dhëna personale të personave për të cilët kërkohet informacion. Nuk mund të botohen të dhënat personale ashtu siç janë. Pra, ka rëndësi të mbrohet jo vetëm identiteti i kërkuarit, por edhe të dhënat personale që mund t’i përmbajë vetë informacioni. Ky është një nga shqetësimet që nxjerr ky nen.

Fatmir Xhafaj – Çfarë mendon ministria?

Edlira Jorgaqi – Në riformulimin e parë ndryshon vetëm një fjalë. Në projektin e ardhur nga qeveria përdoret dy herë termi “mjedis”, ndërsa propozimi është që tek i dyti fjalët “mjedise” zëvendësohen me “zyrat”. Në parim nuk jemi kundër.

Ndërsa kjo që propozohet është për paragrafin e dytë të nenit 8. Çfarë nuk shkon? Është e njëjtë ajo që thoni.

Fatmir Xhafaj – Po, është gati e njëjta. Kush është dakord me riformulimin nga “mjedis” në “zyrat”?

Vasilika Hysi – Këtu janë shtuar vetëm fjalët “mund të vendosë standarde”.

Edlira Jorgaqi – Është më mirë kur i thua: “bën” sesa “mund”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Pse, gjykata e gjykon Presidentin? Ekzekutivi përcakton dhe ky është... Prandaj është. Nuk ka ndonjë gjë të keqe. Ai format është. Në rregull.

Miratohet neni 8 me ndryshimin.

Neni 9 “Informacioni i dhënë më parë”. Ka vërejtje ose sugjerime? Relatorja nuk ka gjë.

Dakord?

Miratohet.

Neni 10. Ka vërejtje nga kolegët? Relatorja? Nuk ka.

Biem dakord? Dakord.

Faleminderit!

Neni 11.

Vasilika Hysi – Ka vetëm një gjë të vogël.

Neni 11 bën fjalë për kërkesën për informim dhe njihet e drejta edhe e kërkesës së dërguar me postë elektronike. Është sugjeruar që, kur bëhet një kërkesë nëpërmjet postës elektronike, personit të mos i kërkohej nënshkrimi i tij. Është shumë i vështirë.

Në këtë kuadër, kërkojmë që identiteti i saktë i kërkuesit dhe nënshkrimi i tij të jetë kur dërgohet kërkesa për informacion dorazi ose me postë, ndërsa për sa i përket dërgimit me postë elektronike të jetë pa nënshkrimin e tij.

Ndaj, ne formulojmë pikën 10 të nenit 11 si më poshtë vijon: “Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi ose me postë, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Kërkesa për informim mund të bëhet edhe me postë elektronike. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji”, siç e ka...

(Deputeti Subashi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Cili është problemi?

Armando Subashi – Për shembull, unë shkoj kërkoj një informacion në iks zyrë.

Vasilika Hysi – Dinë ta bëjnë njerëzit e thjeshtë nënshkrimin? Nuk dinë ta bëjnë.

Fatmir Xhafaj – Të shkojnë atje ta kërkojnë dorazi. Çfarë problemi ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse e kufizon?

Ky ligj në vetvete është shumë i avancuar. Po t’i japim edhe ca gjëra të tjera do ta bëjmë të pazbatueshëm; këtë merak kam unë.

Vasilika Hysi – Është shumë i avancuar, por unë po ia heq, sepse është super i avancuar. Them ai që ka mundësi ta bëjë me postë elektronike, le ta bëjë. Ai që s’ka mundësi, s’do ta bëjë, sa të mësohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Armando Subashi – Po të hap unë një adresë elektronike në emrin tënd, shko e kërkoje pastaj.

Fatmir Xhafaj - Hiqeni fare këtë me postë elektronike!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Pse? Çfarë garancie ka kjo?

Unë mund të hap një adresë fiktive dhe kërkoj disa të dhëna. Si do ta zgjidhni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Flisni me mikrofon, ju lutem!

Edlira Jorgaqi – Në një situatë të tillë është një mundësi që organi të vihet në lëvizje nga pikëpamja administrative, për të parë nëse qëndron kërkesa e paraqitur apo jo. Kjo është thjesht një kërkesë. Ndoshta mund të gjendet një riformulim që në rastin e postës elektronike të mos jetë e detyrueshme ajo që thotë zonja Hysi, që nënshkrimi në këtë rast i bie të jetë nënshkrim elektronik, por të jetë një riformulim ku të thuhet: sipas rastit. Kur është mundësia ...

Fatmir Xhafaj - E lëmë kështu siç është dhe pastaj... Dakord. Mos ta koklavisim. Kam merak se sa më i komplikuar të bëhet ligji, aq më pak i zbatueshëm është, zonja Jorgaqi. Kijeni në konsideratë, sepse e kam nga përvoja: sa më i komplikuar të jetë një ligj, aq më pak i zbatueshëm është, sidomos, për qytetarin. Ky është shqetësimi im. Këtë ligj nuk po e bëjmë për zyrat, për nëpunësin publik, por për qytetarin.

Dakord.

Neni 11, kishit gjë zonja Jorgaqi?

Si e lamë? E lamë siç është ?

Edlira Jorgaqi – Ndoshta mund të kërkojë një riformulim të çështja e dërgimit me postë elektronike, që të mos jetë e detyrueshme me nënshkrim elektronik.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, jam dakord me sugjerimin tuaj.

Neni 12.

Vasilika Hysi – Në nenin 12, bëhet fjalë për pikën 2, kur autoriteti publik e shqyrton kërkesën dhe konstaton se nuk zotëron informacionin e kërkuar. Projektligji lë afat jo më vonë se 10 ditë pune nga data e dorëzimit që autoriteti publik, të vërë në dijeni kërkuar. Sugjerohet që të vihet jo më pak se 10 ditë, është thjesht për të konstatuar nëse e ka apo jo informacionin. Pas këtij afati, fillojnë afate të tjera që personi do t'i drejtohet një autoriteti tjetër për të kërkuar informacion dhe kësaj i shtohet edhe një afat tjetër gjatë të cilit autoriteti detyrohet t'i përgjigjet kërkesës së bërë nga personi. Pra, të vihet: “jo më pak se 5 ditë” thjesht për të parë nëse e ka apo nuk e ka informacionin.

Fatmir Xhafaj - Po mos do kohë ta shikojë, ta bëjë, që të mos i vëmë lakun në fyt? Ta vëmë 10 ditë kalendarike në vend të: “10 ditë pune”.

Jeni dakord?

Zonja Jorgaqi, jeni dakord?

Edlira Jorgaqi – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, kalon neni 12 me këtë ndryshim të vogël.

Neni 13.

Vasilika Hysi –Në fakt, ky nen është një risi shumë e mirë, pasi i vë autoritetet publike në një pozitë që të mos vënë tarifa abuzive, por të vënë vetëm koston e riprodhimit të informacionit të kërkuar. Është sugjeruar nga grupet e interesit, bazuar edhe në Kodin e Procedurave Administrative, të shtohet vetëm një paragraf: “Shërbimet në administratën publike janë pa pagesë. Informacioni i dhënë në rrugë elektronike është falas”. Pra, nuk ka kosto. Pjesa tjetër vazhdon, siç është në projektin e sjellë nga qeveria.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, por organizatat e shoqërisë civile i bëjnë pa pagesë shërbimet e tyre?

Vasilika Hysi – Po, pa pagesë.

Fatmir Xhafaj – Pa pagesë i bëjnë, me gjithë ato fonde që marrin?

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Edlira Jorgaqi – Në fakt, shërbimet e administratës publike janë falas në parim. Rastet me kosto i ka parashikuar shprehimisht neni 13.

Fatmir Xhafaj – Përse duhen vendosur edhe këtu, kur ato i rregullon kodi vetë?

Edlira Jorgaqi – Përderisa është një ligj që rregullon një të drejtë...

Fatmir Xhafaj – Në rregull, a jeni dakord ta vendosni edhe ju?

Edlira Jorgaqi – Jemi dakord ta vendosim, por duhet ndryshuar titulli i dispozitës, sepse në rast se e vendos si pikë të parë që shërbimet janë falas, nuk shkon më përmbajtja e nenit, me koston e shërbimit. Kështu që duhet ndryshuar titulli.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, kalon neni 13 me riformulimin e titullit dhe me paragrafin: “Shërbimet në administratën publike janë pa pagesë”.

Neni 14. Kush është dakord? Nuk ka vërejtje.

Miratohet.

Neni 15. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 17.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Ky nen bën fjalë për kufizimet: “E drejta e informimit kufizohet”. Unë sugjeroj të themi: mund të kufizohet, pasi jo në çdo rast e drejta e informimit kufizohet. Ajo vlerësohet në varësi të interesit publik më të lartë dhe është dikush tjetër që e vlerëson nëse duhet të kufizohet apo jo. Ky ishte komenti i parë lidhur me pikën 1 të nenit 17.

Komenti i dytë është lidhur me pikën 2 të këtij neni. Kam një sugjerim, meqenëse ne kemi ndryshuar shpesh legjislacionin dhe ai mund të krijojë probleme, te germa “a”, pika 2 e nenit 17, kur thuhet se e drejta për informim kufizohet, në një nga këto raste për sigurinë kombëtare, ashtu siç përkufizohet nga ligji, sugjeroj të hiqet numri i ligjit, por të themi: nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar. Mund të ndodhë që ky ligj të shfuqizohet dhe të ketë një numër tjetër, ndërkohë që na intereson përmbajtja ose mbrojtja që legjislacioni në fuqi i bën informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”. Pra, të mos përmendim numrin dhe datën e ligjit, por legjislacionin që është në fuqi lidhur me informacionin e klasifikuar.

Pika 5: “Kufizimi i të drejtës për informim lidhur me Forcat e Armatosura”. Në konsultim me Ministrinë e Mbrojtjes, me zonjën Kodheli u quajt i tepër ky kufizim, pasi paragrafi i dytë i nenit 17 e garanton kufizimin e të drejtës së informimit kur bëhet fjalë për informacione të klasifikuara “sekret shtetëror” dhe nuk ka pse të vëmë kufizime vetëm për një institucion, ndërkohë që ligji rregullon kufizimet në bazë të natyrës që ka informacioni, por jo të institucionit që e mban. Në këtë logjikë i bie të përmendim edhe SHISH-in, Ministrinë e Brendshme, si edhe organe të tjera që kanë të dhëna që klasifikohen “sekret shtetëror”.

Nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit ka pasur një diskutim lidhur me germet “c” dhe “d” të pikës 2, neni 17, ku kufizohet e drejta për informim në mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor dhe për të ruajtur barazinë e palëve në një proces gjyqësor, si edhe mbarëvajtjen e

procesit gjyqësor. Krijohet përshtypja se kjo gjë vazhdon edhe më pas, por me sa kuptoj unë qëllimi këtu ka qenë, për mbarëvajtjen e procesit kur hetimi administrativ është në proces. Prandaj është mirë ta saktësojmë se, pasi procesi ka përfunduar, gjithkush ka të drejtë të marrë në CD të gjithë ecurinë e procesit ose vendimet gjyqësore. Besoj se fjala këtu është për pjesën në proces, pra kur ka një mbarëvajtje të hetimit administrativ në kuadër të procedimit disiplinor në proces, mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit të auditimit të autoriteteve publike, sepse kur mbaron auditimi, besoj se të gjithë kemi të drejtë të marrim raportin e KLSH-së, raportin e Auditit të Brendshëm dhe të njihemi sesi ka ecur ky proces.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Jorgaqi.

Edlira Jorgaqi - Në lidhje me propozimin e parë, që të shtohet një fjalë “mund”, teknikisht mund të bëhet dhe nuk jemi kundër, por argumenti mbështetës do të lidhet me Kushtetutën më tepër, sesa me atë që u dëgjua.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për pikën 1 nuk është se në mënyrën sesi është formuluar paragrafi i parë është detyrues, që e kufizon me domosdo të drejtën për t’u informuar, por mënyra sesi është formuluar paragrafi i parë, është e parashikuar: “kufizohet e drejta për t’u informuar”, por sipas parashikimeve të mëposhtme, po të shkojmë deri në fund të fjalisë, parashikimet e mëposhtme janë germat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, pra, nuk është detyruese, por kufizohet sipas parashikimeve të saj.

Në parim qëndron dhe jemi dakord, duke iu referuar edhe një formulimi që bën Kushtetuta, në rastet e përgjithshme të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që fare mirë mund të transfuzohet edhe këtu.

Fatmir Xhafaj – Po, po për tjetrën?

Edlira Jorgaqi - Ndërsa argumentet për Ministrinë e Mbrojtjes, do të thosha se përderisa vetë ministria përgjegjëse i çmon të tepërta, unë nuk kam ndonjë gjë.

Fatmir Xhafaj - Për nenin 5, duhet hequr.

Edlira Jorgaqi - Përderisa vetë Ministria e Mbrojtjes e çmon kështu...

Fatmir Xhafaj - A jeni dakord me këto sugjerime?

Edlira Jorgaqi – Në fakt, komentet që janë bërë nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura unë i kam studiuar dhe vlejnjë të diskutohen.

Fatmir Xhafaj – Cili është komenti juaj?

Edlira Jorgaqi – Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura thotë se këto parashikime mund të bëhen shkak për interpretime të ligjit, që çojnë në dëm të interesave të qytetarëve, por ne nuk i çmojmë të tilla.

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi – Zonja Jorgaqi, a mund të kufizohet e drejta për informim kur një person kërkon të dijë sesi ka ecur hetimi administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor dhe procedimi ka mbaruar? A ka të drejtë të marrë një informacion?

Ne themi se e drejta e informimit kufizohet dhe dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtme, siç janë mbarëvajtja e procedurave të inspektimit dhe auditimit, kur ky proces ka përfunduar. Unë mendoj se këtu bëhet fjalë kur hetimi administrativ dhe inspektimi e auditit janë në proces, por jo kur kanë përfunduar. Kushdo ka të drejtë të marrë raportin publik dhe të njihet me gjetjet e tij.

Ky është një shqetësim që e ka ngritur Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura dhe mendoj se ka vend për ta parë, sepse mund të lindë një keqinterpretim. Pra: “E drejta e informimit kufizohet, në rast se është e domosdoshme, për mbarëvajtjen e hetimit administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor që është në proces”. Po ta lëmë: “...në mbarëvajtjen e hetimit administrativ, në kuadër të një procedimi disiplinor”, nuk del e qartë nëse bëhet fjalë kur ai është në proces apo edhe kur ka mbaruar si proces.

Edlira Jorgaqi – Zonja Hysi, kur ka përfunduar procesi nuk ka më hetim administrativ, nuk është më hetim.

Fatmir Xhafaj – Mua më duket korrekte.

A jeni dakord me sugjerimet e tjera që u bënë? Dakord.

A jeni dakord me nenin 17? Dakord.

Miratohet neni 17, me sugjerimet e bëra.

Neni 18 “Kundërvajtjet administrative”.

Vasilika Hysi – Ne kemi diskutuar me Ministrinë e Drejtësisë për rishikimin e këtij neni, pasi kundërvajtjet administrative nuk janë të klasifikuara në nivelin e shkeljeve të lehta, të mesme dhe të rënda, për rrjedhojë edhe masa e gjobës duhet të jetë në proporcion me rëndesën e shkeljes. Ministria e Drejtësisë ka sjellë një reformulim, duke

vënë gjobën përkatëse për secilën nga kundërvajtjet administrative, por gjobat i ka vënë në nivel page mujore dhe dënim fikse. Ne mendojmë se gjoba nuk mund të jetë në bazë të një page mujore, sepse niveli i pagave për pozicione të ndryshme, që kanë personat përgjegjës të ngarkuar me këtë punë, nuk është i njëjtë. Në këtë kuadër, për të njëjtën shkelje ka masë gjobe të ndryshme. Çështja tjetër është që nuk mund të kemi një gjobë fikse, por ajo duhet të ketë një minimum dhe maksimum, sepse çdo shkelje ka natyrën e saj dhe nuk është e të njëjtës rëndësie. Aq më tepër ne kemi edhe një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që i ndalon gjobat fikse. Prandaj kërkoj që, përveç kësaj pune shumë të mirë që ka bërë Ministria e Drejtësisë, që e ka nisur këtë proces riformulimi dhe saktësimi të këtij neni, të kalojmë te dënime, të cilat nuk duhet të jenë me paga, por me masë gjobe, siç e kanë edhe ligjet e tjera. Po ashtu të ketë një minimum dhe maksimum të dënimit me gjobë.

Fatmir Xhafaj – Zonja Jorgaqi, keni fjalën.

Edlira Jorgaqi – Ministria e Drejtësisë në fillim të neni 18 ka propozuar që të renditen të gjitha shkeljet administrative. Ndërsa të neni 21 ka parashikuar sanksionet administrative për shkak të këtyre shkeljeve. Aty thuhet se për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 18 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos mbi personat përgjegjës gjobë nga 1 deri në 6 paga mujore.

Fatmir Xhafaj – Çfarë doni të ndryshoni?

Edlira Jorgaqi – Ky është propozimi që ka ardhur nga qeveria.

Fatmir Xhafaj – Çfarë doni të bëni të neni 18?

Vasilika Hysi – Nenet 18 dhe 21 kanë lidhje

Fatmir Xhafaj – Po, dakord, të neni 18?

Vasilika Hysi – Neni 18 përmend shkeljet, por nuk vë sanksionet për çdo shkelje, ndërkohë që neni 21 i lë shumë diskrecion komisionerit.

Fatmir Xhafaj – Kur të shkojmë te neni 21...

Vasilika Hysi – Por janë të lidhura këto.

Fatmir Xhafaj – Pse?

Vasilika Hysi – Sepse po të shikoni ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të sanksionet administrative, sanksionet janë të përcaktuara për çdo shkelje dhe në masë: në minimum dhe në maksimum.

Fatmir Xhafaj - Prandaj e kanë lënë ata nga një deri në ...

Vasilika Hysi – Ky bie ndesh me ligjin që po diskutojmë. Komisioneri do të ketë dy lloj mundësish.

Fatmir Xhafaj - Po le t'i ketë, çfarë problemi ka?

Vasilika Hysi - Është i njëjti komisioner...

Fatmir Xhafaj – Më fal, zonja Hysi, këtu janë nja 12. Për të 12-ta këto do të vendosë nga një...

Vasilika Hysi – Edhe te ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” për çdo shkelje janë mbi 12, aty i kemi vënë gjobat për çdo paragraf, sepse komisioneri ka një diskrecion shumë të madh dhe nga 1 deri në 6 paga, pagat janë nga 300 mijë lekë deri në një milion lekë, dhe të japësh gjashtë paga, 6 milionë lekë, për një shkelje ku në një institucion një vend ia jep 300 mijë lekë, nuk është e drejtë. Pra, ka një diferencë shumë të madhe nga institucioni në institucion, sepse pagat janë të ndryshme. Prandaj është më mirë të kemi pagë fikse, dhe duhet të kemi parasysh që kjo lloj gjobe në ç’raport duhet të jetë me gjobën penale, se dalin gjobat administrative shumë më lart se gjobat penale për shkeljet administrative.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhëroni!

Edlira Jorgaqi – Atëherë, nga pikëpamja ligjore nuk shoh ndonjë pengesë që Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në standardin dhe në zbatimin e regjimit juridik të mbrojtjes së të drejtës për informim të zbatojë këtë lloj parashikimi që ka sjellë qeveria dhe për mbrojtjen e të dhënave personale të ketë një regjim të ndryshëm, nuk shoh ndonjë kundërshti të kësaj natyre.

Së dyti, në rast se i lihet në diskrecion një autoriteti, sikurse është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që emërohet nga Kuvendi, të çmojë që masa dhe sanksioni i dënimit të jetë nga një deri në gjashtë paga mujore, nuk përbën shqetësim kjo gjë. Të paktën mund të lihet si fillim që të shohim si do të funksionojë. Në rast se do të shikojmë se ka abuzime, masa e dënimit është e njëjtë, lloji i dënimit është i njëjtë, pavarësisht masës së pagës. Ajo që jep shprehimisht ligji “Për kundërvajtjet administrative”, ligji kuadër, për vendosjen e masave dhe të gjobave administrative, është i tillë që e lë në diskrecion të ligjvënësit nëse do të vendosë një gjobë fikse apo do të vendosë një gjobë të tillë që të jetë në minimumin ose në maksimumin e vlerësuar. Pra,

është tërësisht në përputhje me ligjin parashikimi i sjellë nga qeveria dhe në harmoni me legjislacionin mbështetës.

Mënyra sesi do të shlyhet gjoba pastaj, Ministria e Drejtësisë e ka sjellë një formulim, dhe mund t'i lihet në diskrecion, ose ta parashikojmë thjesht në ligj, ose t'ia delegojmë komisionarit për Mbrojtjen e të Dhënave që, në rast kur vendos një gjobë të lartë, të themi deri në gjashtë paga mujore, mënyra e shlyerjes të jetë me këste, fjala vjen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord. Jemi dakord me variantin e ministrisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, ministria nuk ka sjellë variante.

Vasilika Hysi – Po, ka sjellë.

Armando Subashi – Unë mendoj se nga ajo që ngriti relatorja, dy janë shqetësimet: së pari, sipas relatores duhet të bëhej një unifikim i sanksioneve tek të dy ligjet, por që unë mendoj se këtu nuk përbën ndonjë problem, se nëse atje parashikohen cilat janë kundërvajtjet administrative në mbrojtjen e të dhënave personale, dhe mbi këtë bazë edhe sanksionet përkatëse, këtu jepen cilat janë kundërvajtjet administrative në të drejtën e informimit dhe sanksionet përkatëse. Vërtet të dyja këto janë të përqendruara në një dorë, por janë dy fusha të ndryshme, që besoj se këtu nuk përbën ndonjë problem. Ndërsa ajo që ndoshta mund të shikojmë, është problemi i sanksioneve, i gjobave, sepse në fakt mund ta kufizojnë të drejtën e informimit dy zyrtarë, ku njëri e ka pagën, po themi 40 mijë lekë të reja në muaj, dhe njëri e ka 150 mijë, ose një milion e gjysmë të vjetra në muaj, dhe një pagë e këtij, gjobë po themi, nuk është njësoj me një pagë të këtij. Pra, këtu, në thelbin e vet, ligji nuk i ndëshkon njësoj dy zyrtarë, ndërkohë që shkelja që bëjnë është e njëjtë. Pra, të dy refuzojnë të drejtën për të informuar, por meqenëse ky ka një pagë të ulët, ky do të marrë një gjobë 300 mijë lekë të vjetra, dhe meqenëse ky ka një pagë të lartë, do të marrë një milion e gjysmë lekë të vjetra.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, po ia lamë ne një pagë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, me këtë çfarë dua të them? Me këtë dua të them se ndoshta mund të shikojmë formulimin klasik të sanksioneve, pra, dënohet nga kaq deri në kaq, dhe pastaj e

ka komisioneri në dorë. Por në qoftë se ne i themi nga një deri në gjashtë paga, sikur edhe minimumin të më japë mua ai, në qoftë se unë pagën e kam një milion e gjysmë, një milion e gjysmë do të dënohem, sepse atë është minimumi i pagës, një pagë, ndërkohë që tjetri prapë me një pagë dënohet 300 mijë lekë.

Bashkim Fino – Parafolësi u mundua të japë një zgjidhje, por nuk i dha asnjë zgjidhje kësaj gjëje. Në qoftë se thotë nga një deri në gjashtë paga, është në dorën e komisionerit, të cilin e emëron Kuvendi, t'i japë verdiktin se sa do ta bëjë këtë gjobë. Por edhe në qoftë se ju thoni se ai të mos e vërë deri në 6 paga, por ta vëmë kuotën nga 1 milion deri në 3 milionë, po marr shembull, atëherë, edhe ai që ka pagën 40 mijë, edhe ai që ka pagën 1 milion, kur komisioneri t'u vërë gjobë nga 1 milion të dyve, nuk do të rëndohen të dy njësoj, njëri do të rëndohet më shumë. Unë mendoj se duhet të kemi më shumë përgjegjësi dhe më shumë besim te këta njerëz që kemi zgjedhur. Me qenë se ai komisioner ka një ligj të caktuar dhe është zgjedhur nga Kuvendi ne t'i japim mundësinë që ai të bëjë punën e vet, pa paragjykuar, pa menduar sesi do ta vërë gjobën ai që e ka pagën 40 mijë lekë dhe për atë që e ka 1 milion lekë. Unë mendoj se është shumë mirë këtu në ligj.

Fatmir Xhafaj – Po, urdhërn.

Mark Frroku – Unë mendoj që ta sanksionojmë dhe ta përcaktojmë 1 pagë ose 2 paga. Pastaj, pavarësisht se sa e kanë pagën ai, që e ka 1 milion le të paguajë një pagë 1 milionë apo dy paga 2 milion, tjetri të paguajë 80 mijë të reja apo 800 mijë të vjetra, dy paga. Ta sanksionojmë një apo dy paga apo tri paga, sepse mund të ketë abuzime edhe nga komisioneri që do të vendosim ne. Njëri është i nënës, tjetri është i njerks dhe i vihet pastaj x gjobë njërit dhe y gjobë tjetrit.

Fatmir Xhafaj – Zonja Jorgaqi, jeni dakord me propozimin që është këtu apo keni sjellë variant tjetër po më thotë, zonja Hysi?

Edlira Jorgaqi – Ne mbështesim variantin e qeverisë. Por në diskutimet që kemi pasur dhe me relatorin, zonjën Hysi, propozimi i saj ishte që të mos jetë e tillë, pra, të lihet në diskrecion të komisionerit nga 1 deri në 6 paga me argumentet që dëgjuam, por të jetë me masë fikse. Dhe për ta mbështetur ne kemi bërë një riformulim të kësaj natyre me masë fikse, por gjithmonë në referencë pagën mujore, duke bërë një klasifikim të shkëlqeve në të rënda, të mesme dhe të lehta. Për mënyrën e shlyerjes së dënimit, të

masës së gjobës, kemi bërë një riformulim tjetër, një dispozitë tjetër që të jetë me këste. Në Kodin e Punës, në nenin 123, është e parashikuar shprehimisht që paga është e paprekshme ose në rast kur preket, ai që do të marrë masën e gjobës, duhet të marrë në konsideratë ruajtjen e minimumit jetik me qëllim që familja e punonjësit që titullohet përgjegjës të mos ketë problematika të jetesës.

Fatmir Xhafaj –Dakord. Mua më duken të arsyeshme formulimet tuaja, sepse këtu janë 16 shkelje dhe ato nuk janë të njëjta për nga pikëpamja e përgjegjësisë. Një kategorizim i tyre do të ishte pozitiv ashtu siç thoni ju. Atëherë, biem dakord me propozimin që ka sjellë ministria?

Dakord, me nenin 18 me propozimin e zonjës Jorgaqi. Faleminderit!

Neni 19. Dakord.

Neni 20.

Vasilika Hysi – Në fakt neni 20 bëhet me qëllim që të jetë edhe në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ku rregullohen në mënyrë mjaft të veçantë marrëdhëniet e Komisionerit me Kuvendin. Sugjerohet të shtohet një paragraf ku të thuhet që: “Komisioneri mund t’i drejtohet Kuvendit, të dëgjohet për çështjet që i çmon të rëndësishme”. Gjithashtu, pika 3 e këtij nenin të riformulohet

Fatmir Xhafaj – Është te ligji kjo?

Vasilika Hysi – Po te ligji aktual.

Fatmir Xhafaj – Po deri sa është te ligji aktual pse ta përsërisim atëherë?

Vasilika Hysi - Po këtu thuhet: “Marrëdhënia e Komisionerit për të drejtën për informim dhe mbrojtje”, aty thuhet se “për mbrojtjen e të dhënave personale për çështjet brenda saj, ai i drejtohet Kuvendit” po ndërkohë edhe për të drejtën për informim...

Fatmir Xhafaj – Po e ka rregull të përgjithshëm ai.

Vasilika Hysi – Atëherë duhet ta rregullojmë ose aty duhet ta shtojmë dhe për këtë fushë të re që i shtohet. Por përderisa, zoti kryetar, në këtë nen të posaçëm ne kemi një nen “Marrëdhëniet me Kuvendin” duhet të themi se çfarë lloj marrëdhëniesh me Kuvendin do të ketë Komisioneri.

Gjithashtu, pika 3 e këtij neni sugjeroj të riformulohet: “Gjatë përpilimit të raportit Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbledh të dhëna nga autoritete publike si dhe nga organizatat jofitimprurëse që kanë për

mision mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore duke evidentuar komunikimet përkatëse”. Kjo buron edhe nga ligji bazë i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Po, zonja Jorgaqi.

Edlira Jorgaqi – Në propozimin që bën relatorja e projektligjit, shtohet thjesht një fjalë, sepse rregulli i përgjithshëm është që “gjatë përpilimit të raportit komisioneri për të drejtën e informimit mbledh të dhëna nga autoritetet publike”. Pikërisht, këtu shtohet një fjalë “si dhe nga organizatat jofitimprurëse”. Në parim ne jemi dakord, por jo me lidhëzën “si dhe” të jetë detyruese që përpilimi i raportit të komisionerit përpara Kuvendit të hartohet në një mënyrë të tillë, që të përmbajë të dhëna detyruese edhe nga autoriteti publik, edhe nga organizatat fitimprurëse. Sepse, supozojmë se një moment nuk i erdhën të dhënat nga organizatat jo fitimprurëse. Do të jetë i munguar në përmbajtje.

Fatmir Xhafaj – Dakord

Edlira Jorgaqi – Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimin dhe me ndryshimin që bën zonja Jorgaqi?

Dakord. Miratohet me këtë ndryshim. Faleminderit!

Neni 21.

Kam një pyetje unë; mos është shumë deri në gjashtë paga mujore?

(Diskutime pa mikrofon)

Tani, s’ka informuar, s’ka bërë. Gjashtë paga mujore nuk janë pak. Tani, prisni një minutë. Pse s’ka fotokopjuar? Pse s’ia ka dorëzuar të dhënat? Mund ta lidhim, që ta shikojmë këtë bashkë, kur të sillni ndryshimet e nenit 18 me kategorizimin? Në rregull, dakord atëherë!

(Diskutime pa mikrofon)

Rast ekstrem është ai.

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull. Atëherë, do të duam që para votimit në tërësi, t’i shohim ato të formuluar, që të kemi një ide më të qartë. Në rregull?

Neni 22: Ankimimi.

Vasilika Hysi – Kam vetëm një gjë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Në lidhje me nenin 22 sugjerohet që fjala “kundërvajtësi” të zëvendësohet me shprehjen “personi ndaj të cilit janë marrë masa”, sepse në fund të fundit...

Fatmir Xhafaj – Dakord?

Armando Subashi – Afati duhet kalkuluar me ligjin për gjykatat administrative.

Fatmir Xhafaj – Sa është afati?

Edlira Jorgaqi – Në fakt, termi i përdorur nuk është gabim. Në parim ne jemi dakord, por nuk është gabim. Thjesht për ta sqaruar. Edhe ligji për kundërvajtjet administrative përdor këtë term, termin “kundërvajtës”. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Neni 23?

Dakord.

Neni 24?

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ministria ka sjellë një riformulim lidhur me mënyrën se si arkëtohet shuma e detyrimeve, duke bërë arkëtimin me këste dhe në fakt, ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që nuk mund t’ia marrësh rrogën komplet dhe ta lësh pa mjetet e jetesës. Unë jam me riformulimin që ka sjellë Ministria e Drejtësisë, por ka një problem. Nëse do të pranohet riformulimi i dytë, që ka sjellë Ministria e Drejtësisë, ku thuhet se pagesa e kësteve bëhet deri në gjashtë muaj, në lidhje me këtë duhet të shohim dhe rregullimin që ka projekti i qeverisë, ku thuhet se gjoba ekzekutohet jo më vonë se tridhjetë ditë, sepse ka përplasje mes variantit të qeverisë dhe riformulimit që po i bën Ministria e Drejtësisë. Prandaj duhet parë edhe në këndvështrim.

Fatmir Xhafaj – Po pra, ramë dakord që janë të lidhur neni 18, 21 dhe 23. Me ndryshimin, ramë dakord?

Dakord!

Neni 24.

(Diskutime pa mikrofon)

Armando Subashi – Tani, këtu duhen hequr këto “ditë punë”, por përgjithësisht as ligjet nuk e njohin këtë.

Fatmir Xhafaj – Po.

Armando Subashi – Njohin afatet në ditë kalendarike.

Fatmir Xhafaj – Të bëjmë të njëjtin rregullim. Nuk ka nevojë ditë pune, ditë kalendarike.

Ka vërejtje të tjera?

Dakord!

Neni 25: “Ankimi në gjykatë”.

Dakord, besoj!

Neni 26: “Shpërblimi i dëmit”.

Dakord!

Vasilika Hysi – Një gjë kam, zoti kryetar. Kodi Civil, në dijeninë time, ka ndryshuar dhe duhet të themi: sipas Kodit Civil të ndryshuar. Njëkohësisht, meqenëse ne kemi një problem të ngritur nga Avokati i Popullit, por edhe në përmbajtjen e pikës 7 të nenit 24, meqenëse të drejtën për informim e ka në kompetencë edhe Avokati i Popullit, e ka edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në ligjin për Avokatin e Popullit, që po diskutohet dhe do të kalojë në diskutim nën për nen edhe në këtë komision, ne duhet të shtojmë një paragraf, ku të theksojmë se Avokati i Popullit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nënshkruajnë një memorandum bashkëpunimi, ku specifikohet mënyra e bashkëpunimit për trajtimin e rastit të shkeljes së të drejtës për informim. Kjo sepse, dhënia e kësaj kompetence Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale nuk e shmang Avokatin e Popullit, që ai të monitorojë respektimin e të drejtës për informim dhe të paraqesë çështjet në Gjykatën Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Këtu jemi te problemi i dëmit, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Jo, jo, iku ajo, mbaroi.

(Diskutime pa mikrofon)

Lidhet me 24-ën kjo.

Fatmir Xhafaj – Një minutë, një minutë! Këtu jemi te neni 26. Ka kaluar neni 24.

(Diskutime pa mikrofon)

Këtu jemi te neni 26. Kaloi neni 24.

Neni 27.

Neni 28.

Armando Subashi – A të bëj një pyetje te neni 26, për ta saktësuar?

Fatmir Xhafaj – Çfarë problemi ka neni 24? A e kaluam 24-ën, Vasilika?

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 28. Dakord?

(Diskutime pa mikrofon)

Në rregull! Edhe një herë neni 28.

E mbyllëm nen për nen, me ndryshimin: neni 18, 21 dhe 23 për t'u paraqitur para votimit në tërësi. Në rregull? Dakord?

Dakord!

Kalojmë te...

(Diskutime pa mikrofon)

... derisa ka një ndryshim për ta parë, do të zbardhën, do të shpërndahen dhe do të votohen në tërësi.

Kush ka ndonjë rezervë, thotë: “Më fal...”. Ky është rregulli. Ju e keni mundësinë se jua jep Kushtetuta.

Mbyllet diskutimi nen për nen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 15.09.2014, ora 10:20

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Dashamir Peza, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku dhe Silva Caka.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Eduard Halimi, Tom Doshi dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Edlira Jorgaqi – drejtore e Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Fjalën e ka zonja Caka.

Silva Caka – Komisioni propozon që neni 1 i projektligjit të hiqet. Kjo me arsyen që është i panevojshëm, për shkak se e drejta e informimit po trajtohet në një ligj më vete paralelisht me këtë projektligj dhe në thelb nëpërmjet këtij projektligji ne kemi synuar që të shtojmë vetëm kompetencat e Komisionerit për të Dhënat Personale në kuadër të së drejtës së informimit, por jo të drejtën e informimit në vetvete.

Neni 1 nuk ka pse të jetë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, duhet të jetë thjesht për mbrojtjen e të dhënave personale, sepse nuk po trajtojmë të drejtën e informimit në vetvete. Duke qenë se është një ligj paralel nuk ka pse të jetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord? Dakord.

Neni 2. “Kudo në ligj emërtimi komisioneri”. Jeni dakord?

Silva Caka – Kemi disa shtesa. Pas nenit 2 propozojmë të shtohet neni 2/1, që normalisht do të numërohet më vonë, me përmbajtje si më poshtë: “Neni 2/1, parashikon që në nenin 3 të ligjit aktual, i cili parashikon përkufizimet, pas pikës 27 të shtohen dy pika, 28 dhe 29, me përmbajtje respektive si më poshtë: “Pika 28 “e drejtë informimi” ka kuptimin sipas përcaktimit në ligjin “Për të drejtën e informimit”” dhe pika 29 “programet e transparencës” ka kuptimin sipas përcaktimit të ligjit “Për të drejtën e informimit””.

Pas nenit 2/1 shtohet neni 2/2 me këtë përmbajtje: “Në pikën 1 të nenit 29 të ligjit aktual, pas fjalës “personale” të shtohen edhe fjalët “dhe të drejtën e informimit””.

Pas nenit 2/2 të shtohet neni 2/3 me këtë përmbajtje: “Në nenin 30 të ligjit aktual, titulli të ndryshohet si më poshtë vijon: “Të drejtat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale””.

Pas nenit 2/3 shtohet neni 2/4, i cili parashikon se në nenin 31 të ligjit aktual, titulli të ndryshohet si më poshtë: “Kompetencat në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale””.

Fatmir Xhafaj – Zonja Jorgaqi, keni ndonjë koment.

Edlira Jorgaqi – Jo, nuk kam.

Armando Subashi – Ndryshojnë titujt e neneve më pas, apo janë riformulim nenesh?

Silva Caka- Kur të zbatohet teknika legjislativë do të ndryshohen, nuk do të jenë 2/1 dhe 2/2 do të numërohen 2, 3, 4 ...

Fatmir Xhafaj – Neni 3 i projektligjit.

Silva Caka – Në nenin 3 të projektligjit, te pika “ç” në fjalinë e dytë duhet të hiqen fjalët “sipas ligjit nr.8457, datë 11 shkurt 1999 “Për informacionin e klasifikuar shtetëror” të ndryshuar”.

Fatmir Xhafaj – Zonja Jorgaqi, jeni dakord?

Edlira Jorgaqi – Propozimi është i thjeshtë: të hiqen atributet e ligjit.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me këtë ndryshim.

Neni 4. Jeni dakord? Dakord.

Meqenëse u bënë disa ndryshime, është në interesin e të gjithëve dhe unë e kam të nevojshme personalisht për ta parë saktësisht se si janë shprehur ndryshimet, votimin në tërësi për të dyja këto projektligje do ta bëjmë nesër. Do ju lutem relatorëve që së bashku me këshilltarët ta zbardhin duke bërë ndryshimet e nevojshme, në mënyrë që përpara votimit në tërësi të kemi mundësi që ta njohim. Së bashku me zonjën Jorgaqi për propozimet që ka sjellë ministria.

Jeni dakord?

Dakord.

Nesër në orën 10:00 do të shqyrtojmë projektligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”. Mbledhjen e nesërme do ta fillojmë me votimin në tërësi të projektligjeve që sapo kaluam, duke u njohur me reflektimet përkatëse.

Ditën e mirë!

Punë të mbarë!